

12.03.2022

Ora 15:00

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 8, me ankues: anëtari i KZAZ-së nr. 21, Qarku Durrës, me objekt "Kundërshtimi i vendimit nr. 11, datë 26.01.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie të disa njësi vendore të datës 6 Mars 2022".


PJESËMARRJA :

- KAS:
- Stafi KQZ: Y. Merkaj

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje të gjithëve! Sot, në datën 12 mars 2022 do të zhvillohet seanca për shortin për caktimin e relatorit për Kërkesën Ankimore nr.8. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në datën 11.03.2022, ora 12:50 është paraqitur kërkesa ankimore nga ankues Krenar Hasanaj, anëtar i KZAZ-së nr. 21, Qarku Durrës, i cili ankimon vendimin nr.11, datë 26 janar 2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili ka caktuar masën e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022. Procedura e shortit është referuar nenit 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur pesë shirita letre, të bardhë dhe pa shënime, ku në njërin prej tyre është vendosur Kërkesa Ankimore nr. 8, të cilët palosen dhe futen në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një enë transparente. Pasi janë palosur shiritat e letrës dhe janë futur në goglat me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në enën transparente, duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezentë, goglat për llogari të tyre do të tërhiqen nga

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.03.2022*

një përfaqësues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke filluar nga rendi alfabetik rritës, duke filluar nga zoti Elvin Lako.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilirjan Rusmali - Kërkesa Ankimore nr.8.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit, relatori i Kërkesës Ankimore nr. 8 është zoti Ilirjan Rusmali. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

